

Kopshti pa lodra

Informacion për prindërit

Për 3 muaj, lodrat po marrin pushimet - duke lënë pas karrige, tavolina, litarë, rroba, kapëse rrobash, kuti kartoni ... imagjinatën e fëmijëve dhe vetë fëmijët.

Cili është qëllimi i këtij projekti?

Fëmijët kanë kohë më të madhe në dispozicion për të luajtur të shpenguar në kopshtin pa lodra. Ata e vendosin vetë atë që duan të bëjnë. Idetë për aktivitete burojnë nga fëmijët. Brumosen kështu aftësi të rëndësishme për jetën: bashkëbisedimi me njëri-tjetrin, zgjidhja e problemeve së bashku, përcaktimi i asaj që ata duan vetë, aftësia për të kuptuar se si ndihen të tjerët, kapaciteti për negociuar siç duhet ... aftësi që janë të nevojshme për t'u shndërruar në të rinj dhe të rritur të pavarur.

Çfarë do të mësojnë fëmijët nga projekti?



Ndërtimi i gjërave

Si mund t'i rregulloj karriget pa rrëzuar asgjë? Kjo nënkupton të mësosh funksionimin e ligjeve fizike përmes lojës.

Fëmijët shpeshherë planifikojnë projekte ndërtimi me njëri-tjetrin. Ata vënë në zbatim ide që i kontribuojnë grupit, duke marrë rolin e shefit dhe duke mësuar të bëjnë kompromise. Mësojnë të luajnë së bashku në vend që secili të luajë për hesap të vet! Kjo kërkon zbatim në praktikë.

Ngrënia e një ushqimi të lehtë në pjesën e dytë të mëngjesit

A ndjehem i etur, i uritur, i lodhur apo dëshiroj të ha tani sepse kjo është ajo që po bëjnë dy shokët e mi? Në kopshtin pa lodra fëmijët mund të vendosin vetë kur dhe ku duan ta hanë ushqimin e tyre të pjesës së dytë të mëngjesit. Kjo i lejon fëmijët të mësojnë të perceptojnë sinjalet nga trupi i tyre dhe të marrin në konsideratë dëshirat sociale siç janë "të ngrënit së bashku".

Aftësia për të argumentuar dhe negociuar

Fëmijët praktikojnë shprehjen e mendimeve të tyre personale dhe afirmimin e vetvetes. Ata bëhen më të guximshëm dhe fitojnë aftësi për të formuluar qartë dëshirat e tyre. Ata mësojnë të shprehin ndjenjat e tyre, duke zgjeruar për pasojë gradualisht fjalorin e tyre.

Ndjesia e mërziisë

Është plotësisht e kuptueshme që fëmijët të mërziiten ndonjëherë. Në kopshtin pa lodra, edukatorja e kopshtit rri pasive dhe i jep fëmijës kohë për të gjetur një zgjidhje e për të dale nga mërzia. Ndonjëherë është OK që thjesht të uleni dhe të vëzhgoni se çfarë po ndodh dhe të fiksoni

hapësirën. Fëmijët inkurajohen të zhvillojnë një ide të re për lojën e tyre. Mërzia është shpesh parakusht për krijimtarinë.

Trimërimi

Me anë të lojës, fëmijët krijojnë mundësi për veten e tyre për të kapërcyer frikën dhe për t'u bërë më trima. Kjo mund të nënkuptojë hedhjen nga një tryezë mbi një dyshek të vendosur poshtë. Ata do të hezitojnë nëse dysheku është shumë larg ose nëse fëmijët e tjerë janë akoma mbi dyshek. Ata do të kërkojnë ndihmë, do të ngjiten përsëri për të afruar dyshekun ose do të ngrenë një "kullë kërcimi" më të lartë. Ata ngjiten, hidhen nga lart, zvarriten, kërcejnë... Ata mësojnë të matin forcën e tyre dhe të vlerësojnë më mirë pengesat në mënyrë që të lëndojnë sa më pak veten dhe të tjerët.

Si është një mëngjes tipik në kopshtin e fëmijëve?

Fëmijët mbërrijnë në kopshtin e fëmijëve, heqin vetë rrobat në dhomën e zhveshjes, përshëndesin edukatoren e kopshtit, më pas shkojnë e luajnë. Disa vijnë në kopshtin e fëmijëve me një ide të qartë se çfarë duan të bëjnë, ose vazhdojnë të luajnë aty ku e lanë lojën një ditë më parë. Të tjerët bëjnë shëtitje nëpër kopshtin e fëmijëve në kërkim të një ideje apo loje. Të tjerët ulen dhe shohin se çfarë po ndodh. Ata mund të hanë kur janë të uritur ose kur ndjehen të tillë.

Në fund të gjysmës së ditës, zhvillohen diskutime dhe merret një vendim lidhur me çfarë duhet pastruar dhe si duhet bërë. Më pas edukatorja e kopshtit vlerëson mëngjesin me fëmijët. Çfarë ju pëlqeu më shumë sot? Për çfarë jeni veçanërisht kërenar?

Kopsht pa lodra: a nënkupton kjo se nuk ekzistojnë rregullat?

Absolutisht jo. Rregullat e zakonshme të kopshtit në përgjithësi vazhdojnë të zbatohen. Të tjerat ndryshojnë pak. Fëmijët kanë më shumë zë për të artikuluar dëshirat e tyre.

Disa veprime të përditshme gjithashtu janë ruajtur, ndërsa të tjerët kanë pësuar ndryshime.

Cili është roli i edukatores?

Eduktorja e kopshtit të fëmijëve shoqëron fëmijët deri në një farë pike, duke bërë të mundur që ata të rrisin ndjeshëm aftësitë e tyre. Ata vazhdimisht vëzhgojnë atë që po ndodh në kopshtin e fëmijëve dhe fitojnë një përvojë e një vështrim më të thelluar për statusin e zhvillimit të fëmijëve. Ata i drejtojnë fëmijët në mënyrë që ata të fillojnë të mendojnë vetë. Fëmijët mësojnë shumë duke thënë fjalët e tyre, duke u përfshirë në mënyrën e organizimit të gjërave, duke kontribuar me ide dhe duke marrë përgjegjësi.

Po nëse shqetësohem për fëmijën tim?

Nëse ndjeheni i shqetësuar për diçka ose nëse fëmija juaj nuk dëshiron të shkojë në kopsht, ju lutem kontaktoni edukatoren e kopshtit në mënyrë që të mund të diskutoni lidhur me konstatimet dhe shqetësimet tuaja.

Parandalimi i varësisë dhe kopshti i fëmijëve pa lodra në kantonin Aargau?

Parandalimi i varësisë i kantonit Aargau nisi projektin në kantonin e Aargau në 2002 dhe është aktiv që prej asaj kohe. Personat me aftësi të mira jetësore kanë më pak të ngjarë të zhvillojnë sjellje varësie. Ata gjejnë zgjidhje kur përballen me situata kritike të jetës dhe janë të aftë për të kërkuar dhe pranuar ndihmë. Ata janë të vetëdijshëm dhe e dinë se çfarë janë të aftë të bëjnë. Ata janë në gjendje të gjejnë fjalët e duhura për të përshkruar se si ndihen.

Informacion i mëtejshëm mund të gjendet në www.spielzeugfrei.ch